



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

721/19

26.11.2019

PRISHTINË - PRISTINA



**PSH. nr. 721/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Goran Milenkovic - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “BM GROUP” Sh.p.k-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE: ENTERI SH.P.K.; N.T.SH. ARTECH; TRIO TEK SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vendosja e kamerave për të rritur nivelin e sigurisë, në pikat kryesore të qytetit si dhe në Institucione publike të Komunës së Fushë Kosovës”, me nr prokurimit: 6112-19-6207-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK Fushë Kosovë”, më datë: me 13.11.2019, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “BM GROUP” SH.p.k-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vendosja e kamerave për të rritur nivelin e sigurisë, në pikat kryesore të qytetit si dhe në Institucione publike të Komunës së Fushë Kosovës”, me nr prokurimit: 6112-19-6207-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK Fushë Kosovë”.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vendosja e kamerave për të rritur nivelin e sigurisë, në pikat kryesore të qytetit si dhe në Institucione publike të Komunës së Fushë Kosovës”, me nr prokurimit: 6112-19-6207-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK Fushë Kosovë” dhe lënda kthehet në rivlerësim.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “BM GROUP” SH.p.k-Prishtinë aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues: “BM GROUP” SH.p.k-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP me dt:21.10.2019, me nr. 721/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vendosja e kamerave për të rritur nivelin e sigurisë, në pikat kryesore të qytetit si dhe në Institucione publike të Komunës së Fushë Kosovës”, me nr prokurimit: 6112-19-6207-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK Fushë Kosovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.10.2019, ka autorizuar ekspertin teknik të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti teknik i prokurimit ,në raportin e dt 04.11.2019 sqaron si në vijim:

- Lideri i grupit të operatorëve ekonomik të propozuar për nënshkrimin e kontratës “ENTERI” SH.P.K. ka ofruar pasqyrën tabelave të stafit prej 11 personave teknik, përfshirë këtu edhe vendimin për menaxherin e projektit, ndërsa kërkesa në DT është për minimum 8 punëtorëve teknik. Prej të cilëve 2 Inxhinjera te Elektroteknikes dhe 2 Inxhinjera te Informatikës, që të gjithë me më shumë përvojë pune se sa që është kërkesa nga AK.



- Lideri i grupit të Operatoreve Ekonomik, ka përfshirë edhe: diplomat, CV-të, rekomandimet dhe kontratat e punës në kohë të caktuar për të gjithë të punësuarit të paraqitur në listën e projektit, në përputhje gjithashtu me kërkesat në DT.
- Ndërsa për punëtorin z.Bujar Zabeli, inxhinier i informatikës, i cili është pjesë e listës prej 12 personave të paraqitur nga lideri i grupit të Operatorëve Ekonomik, përpos diplomës dhe certifikatave të ndryshme të CCNA e ka të prezantuar edhe certifikatën e kërkuar të CCNA për rrjetat e telekomunikimit.
- Lideri i grupit të Operatoreve Ekonomik të shpërblyer me kontratë, gjithashtu posedon dhe i ka të bashkangjitura në DT edhe 10 certifikata të lëshuara nga prodhuesi i kamerave Dahua për certifikim të 10 nga 12 personave të paraqitur në listën e punëtorëve të udhëheqësit të grupit të OE, për punë me mjete për video vëzhgime, certifikata të lëshuara para hapjes së këtyre ofertave, në përputhje me kërkesat në DT.

Unë konsideroj që lista e punëtorëve, diplomat, referencat, CV-të dhe dokumentet tjera relevante, të cekura në ankesën e OE ankues, janë në përputhje me kërkesat në DT dhe e propozoj panelin shqyrtues që këtë pjesë të pretendimit të OE ankues, ta refuzoj si të pabazuar.

Përgjigje e ekspertit shqyrtues teknik në pjesën e dytë (pjesë administrative) të pretendimit të OE Ankues. Pretendimi i OE Ankues: 1.2 Kontratat e punëtorëve dhe certifikatat nga prodhuesi i pajisjeve video vëzhguese duket se janë në fazë të re dhe se kuptohet qarte që provoja dhe eksperiencia e punës në këtë lami është e paket tek stafi teknik ku konkretisht me brendinë e paraqitur.

Këtë pretendim e konsideroj si të pabazuar, nuk është me rëndësi kur janë lëshuar certifikatat, ato janë në përputhje me kërkesën në DT dhe i përmbajnë të gjitha specifikat e kërkuara. Përvoja e OE dëshmohet me kontratat dhe referencat e bollshme të cilat i ka të prezantuara në DT.

Pretendimi i OE Ankues: 1.3 Kontratat për të gjithë janë të nënshkruara në të njëjtën ditë me dorëzimin e tenderit në fjalë. Me këtë të bon të kuptosh seriozitetin e grupit të Operatorëve të përzgjedhur.

- Edhe këtë pjesë të pretendimit të OE ankues e konsideroj si të pabazuar, pasi që kontratat janë me afat të caktuar dhe të dedikuara për këtë projekt. Në përputhje me kërkesat dhe specifikat e DT.

Pretendimi i OE Ankues: 1.4 Tek Ingj. I prezantuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik i përzgjedhur për nënshkrimin e kontratës në dokumentin identifikues është me mbiemër tjetër nuk e kemi të qarte se për cilin person bëhet fjalë këtu apo nuk ekziston fare.

Inxhinieri i Diplomuar i Elektroteknikes, i drejtimet Automatika dhe Elektronika, z.Zymer Veliu, në diplomën e kryerjes së studimeve Universitare të lëshuar me datë 30.09.1999 me nr. rendor 1271, në CV, Referenca dhe kontratë të punës me liderin e grupit të Operatorëve Ekonomik të shpërblyer me kontratë, është i identifikuar me emrin Zymer Veliqi, me ditëlindje të njëjtë, kurse në dokumentin identifikues, në certifikatën e diplomës Master nga një Universitet në Zhenevë të Zvicrës dhe në dy certifikata të trajnimeve është i identifikuar me emrin Zymer Veliu. Që për mua është i njëjti person dhe propozoj që pretendimi i OE ankues, të refuzohet si i pabazuar.

Pretendimi ankimor i OE ankues (tek pjesa e specifikave teknike të Grupit të OE të shpërblyer me kontratë)

Citoj: Si pike diskutabile janë edhe specifikat teknike të dorëzuara nga Grupi i Operatoreve ekonomik i përzgjedhur për nënshkrimin e kontratës ku sipas nesh janë specifika të cilat nuk janë ashtu si janë kërkuar, ku janë të sqaruara si më poshtë:

2.1 UPS e ofruar nuk janë sipas kërkesës së AK-së, janë paraqitur ata të cilët nuk i plotësojnë kriteret e dosjes së tenderit.

Përgjigje e ekspertit shqyrtues teknik për pretendimin 2.1.

Te dokumenti “Paramasat për Kamera” nën numrin rendor 21 është artikulli “UPS 20 kVA BRAND NAME”, me sasi një (1) copë. OE, pjesë e grupit të OE të shpallur fitues ka ofruar katalog të detajuar të produktit “PHOENIX 3SU ONLINE UPS” me përshkrim të specifikave teknike. Deklaratë për plotësim të standardit ISO 9001-2015, deklaratë të konformitetit dhe garancion për furnizim me pjesë rezervë për 10 vite pas instalimit, si dhe deklaratë për Garancion prej 24 muajve, të nënshkruar dhe të vulosur nga ana e liderit të Grupit. Karakteristikat dhe kërkesat teknike të paraqitura në Paramasë të DT, janë të paraqitura edhe në katalogun e bashkangjitur nga ana e OE fitues, kurse për disa pozicione për të cilat nuk kam mundur t’i konfirmoj e kam kontaktuar me anë të e-mailit prodhuesin e produktit i cili mi ka konfirmuar të gjitha, për më shumë, po e bashkangjes më poshtë komunikimin.

Me ç’rast jam bindur që produkti i ofertuar nga grupi i OE, është në përputhje të plotë me kërkesat dhe karakteristikat e kërkuara në Paramasën e DT nga ana e AK-së, andaj ky pretendim propozoj që të merret si i pa bazuar.

Pretendimi ankimor i OE ankues (tek pjesa e specifikave teknike të Grupit të OE të shpërblyer me kontratë)

2.2 Tek sistemi i kamerave nga AK ja është kërkuar kamere Bullet 2MP, kurse nga operatori i përzgjedhur është prezantuar DOME kamere, që nuk përputhet me kërkesën.

Përgjigje e ekspertit shqyrtues teknik për pretendimin 2.2.



Kamerat e ofruara nga Grupi i OE të përzgjedhur për kontratë, karakteristikat funksionale dhe teknike të cilave janë të përshkruara në pozicionet 1, 2 dhe 3 të Paramasës në DT, i plotësojnë të gjitha kërkesat e paraqitura në DT.

Kamera e ofruar nga Grupi i OE të përzgjedhur për kontratë, e cila është e përshkruar në pozicionin 4 të paramasës, i plotëson të gjitha kërkesat e paraqitura nga ana e AK në DT.

Sa i përket emertimit DOME te kjo kamerë dhe/apo BULLET si emërtim mund të kompensohet me kushtin/kriterin e përcaktuar si ekuivalent sepse kamera e ofruar nga grupi i OE të shpallur fitues i plotëson të gjitha kërkesat dhe specifikat e kërkuara nga ana e AK-së dhe të paraqitura në Paramasë, si e tillë nuk mund të refuzohet bazuar në emërtimin DOME apo BULLET. Jam shumë i sigurtë se ky emërtim është bartur gabimisht nga personat përgjegjës të AK-së gjatë përpilimit të specifikave teknike të paramasa e artikujve, kjo pasi që 3 artikujt e parë janë BULLET.

Pretendimin ankimor 2.2 të OE ankues që ka të bëjë me kamerat e ofruara nga grupi i OE të shpërblyer me kontratë e konsideroj si të pa bazuar.

Pretendimi ankimor i OE ankues (tek pjesa e specifikave teknike të Grupit të OE të shpërblyer me kontratë)

2.3 Tek monitori i kërkuar nga AK ja është industrial 24/7, kurse Grupi i Operatorëve ekonomik i përzgjedhur, ka ofruar monitor Jo industrial 24/7, që nuk është në përputhje me kërkesat e FTD-se, sipas specifikave teknike.

Përgjigje e ekspertit shqyrtues teknik për pretendimin 2.3.

Grupi i operatorëve ekonomik të shpërblyer me kontratë, për pozicionin 6 të paramasës ka ofertuar me produktin LM49-S400, 49'' UHD LED monitor (gjithsejtë 4 copë), që është i brenditë të njëjtë me kamerat, pra Dahua. Monitori i ofruar i plotëson të gjitha kërkesat teknike të paraqitura në paramasë, të cilat i kam verifikuar në katalogun e dorëzuar nga OE fitues dhe në atë të shkarkuar nga ueb faqja e prodhuesit, në të cilin, ndër karakteristikat të tjera, shkruan edhe: "Industrial level LCD panel, suitable for continuous 24/7 operation", prandaj edhe këtë pretendim të OE ankues e konsideroj si të pa bazuar.

Pretendimi ankimor i OE ankues (tek pjesa e specifikave teknike të Grupit të OE të shpërblyer me kontratë)

2.4 Në kemi ofertuar me çmim me te lire diku 8,000.00 euro, gjë që kemi çmim me te lire dhe ekonomikisht me te favorshëm, ku AK-ja duhet ta marrë parasysh këtë faktë ku si kriter bazik çdo here është Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin me te ulet.

Përgjigje e ekspertit shqyrtues teknik për pretendimin 2.4.

Oferta e OE ankues është më e ulët, por edhe oferta e grupit të operatorëve të shpallur fitues është brenda buxhetit të paraparë nga ana e AK-së.

Komisioni vlerësues e kanë shpallur të papërgjegjshëm OE ankues edhe në nivelin administrativ edhe në atë teknik, madje edhe në sqarimin e kërkesës për rishqyrtim. Këtë pretendim të OE ankues e konsideroj si të pa bazuar.

Pretendimi ankimor i OE ankues (tek pjesa e specifikave teknike të Grupit të OE të shpërblyer me kontratë)

2.5 Ne kemi ofruar Specifikat Teknike sipas kërkesës së AK-së, ku ne i plotësojmë të gjitha kriteret e kërkuara pasi edhe nuk kemi ndonjë pikë të caktuar të kontestuar nga AK-ja, kësaj kërkesë ja bashkëngjisim edhe marrëveshjet me Kompaninë Dahua.

Përgjigje e ekspertit shqyrtues teknik për pretendimin 2.5.

Me datë 11.10.2019, AK është përgjigjur në kërkesën për rishqyrtim të bërë nga ana e OE ankues, duke e refuzuar të njëjtin, pasi e ka rishikuar komplet dosjen dhe e ka rikonfirmuar edhe njëherë vlerësimin e bërë nga ana e komisionit vlerësues pranë AK-së të cilët, OE ankues e kanë shpallur të papërgjegjshëm në raportin e datës 04.10.2019

Unë e kam kontrolluar mirë të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e OE ankues gjatë tërë procedurës së tenderimit dhe gjithashtu edhe konstatimet e AK-së për OE ankues dhe me bindje të plotë e konfirmoj që:

Te katalogjet e produkteve të dorëzuara OE ankues nuk dihet saktë se cilat produkte që janë këto katalogje janë ofruar për pozicionet e paraqitura në paramasë, nuk janë të vulosura dhe të nënshkruara të njëjtat. Nuk ka deklarata të autorizimit nga ana e prodhuesit të produkteve, përpos letra e konfirmimit nga Dahua dhe një kontratë për distribuim jo ekskluzive (në DT kontrata nuk kërkohet të prezantohet), e cila ka datë të skadimit 31.12.2018.

Në dosjen fizike të dorëzuar nga ana e AK-së në OSHP, ndër të tjera është edhe komunikimi i AK-së me prodhuesin e kamerave “Dahua”, të cilët e konfirmojnë që për këtë projekt e përkrahin vetëm grupin e operatorëve ekonomik të shpallur fitues. Shkresa e dërguar nga AK tek Prodhuesi “Dahua” mbanë datën 26.09.2019, kurse përgjigja është me datë 01.10.2019, ky komunikim është në dosjen fizike të dorëzuar në OSHP dhe të njëjtin e kam të skanuar.

Prandaj, duke i marrë parasysh të gjitha këto, edhe unë e konsideroj OE ankues si të papërgjegjshëm, ashtu që edhe këtë pretendim të tij propozoj që të refuzohet si i pa bazuar nga ana e panelit shqyrtues.

Mendimi i ekspertit teknik: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues të OSHP-së, që ankesa e OE “BM GROUP” SH.P.K. - Prishtinë të hedhet poshtë si e pa bazuar dhe të obligohet AK-ja të vazhdojë tutje me procedurën e prokurimit.



Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 05.11.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit teknik.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 04.11.2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit teknik.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 13.11.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së si dhe ekspertet shqyrtues dhe teknik, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Nishevc i deklaroi: Ne si kompani BM Group nuk pajtohemi me mendimin e eksperteve gjatë shqyrtimit të lëndës dhe pikave të eksperteve kanë qenë disa pika shumë të qarta se nga ana jone kanë qenë shumë të dyshimta dhe nuk kanë qenë korrekte kështu që kemi propozuar të ankohejmë përsëri edhe pse ana e eksperteve ka vlerësuar që MAAF dokumenti nga ana e prodhuesit nuk është i prodhuesit dhe nuk është i autorizuar nga prodhuesi por pas ankesës tone direkt tek prodhuesi ne kemi marrë vlerësimet nga prodhuesi ku gjatë ndryshimit të stafit ne piken qendrore në Shqipëri stafi i ri ka marrë mendim pa dijen e kompanisë sonë që ta favorizojnë kompaninë në fjalë ani pse kompania në fjalë tek disa pika kryesore siç është zgjerimi i adresimit publik nuk ka ofruar fare informacione dhe nuk kanë dhënë sqarime mbi atë temë fare kurse ne pika tjera kemi të bëjmë po me të njëjtin prodhues dhe nuk jemi duke ankuar me produkte të ndryshme, dhe behet fjalë me çmimin e konkurrencës në rast se ke autorizim me prodhuesin do të kesh çmimet e tregut dhe po ashtu do të kesh përkrahjen teknike dhe specifike, ku ne kemi përvojë si 4 vite po me të njëjtin prodhues kemi përfunduar shumë projekte së bashku mirëpo me ndryshimin e stafit në Shqipëri ka ndodhur ky keqkuptim apo keqmenaxhim nga ana e tyre dhe ne kërkojmë nga paneli shqyrtues kur vërehen shumica e produkteve nga i njëjti prodhues të merret parasysh çmimi serioziteti i kompanisë tonë ku janë staf 175 person nuk po hyjnë në detale të makinerisë dhe gjerave tjera.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Obertinca deklaroi: kam përgatit vetëm përgjigjet dhe argumentet në pikat pretendon pala ankimore se kemi bre shkelje të LPP-së. Tek pjesa administrative Grupi i OE-ve të shpallur fitues për AP ka ofruar listën e stafit origjinal të nënshkruar dhe vulosur nga OE, duke bashkëngjitur të gjitha dëshmitë për stafin në harmoni të plotë me DT dhe njoftimin për



kontrate, si diploma, certifikatë, CV , kontrata dhe referenca, grupi ne fjalë ka ofruar kontrata te punonjëseve konkret dhe te njëjtat janë para hapjes se ofertave dhe për AK janë ne harmoni te plote me te gjitha kriteret e vendosura ne FDT, vetëm Lideri i grupit ka ofruar 11 punëtor teknik nga 8 te kërkuar, 2 ING te elektro teknikes dhe 2 te informatikës te gjithë me përvojë si ne kërkesën e Autoriteti Kontraktues prandaj pala ankimore ne këtë pik nuk ka bazë. Gjithashtu ne dokumentin identifikues te një ING për AK është i pa rëndësishme sepse GR i OE-ve edhe pa këtë ING i plotëson kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktues si dhe Partneret e konsorciumit kanë ofruar iING qe plotësojnë këtë kriter, këtu nuk ceket se për cilin person behet fjalë nga OE ankues por si duket është tepër Zymer Veliqi i cili pas studimit e përmirëson nga Veliqi ne Velu dhe tani dokumentet e diplomave nuk përputhen me mbiemrin ne letërnjoftim e te gjitha te dhënat tjera janë identike.

Pjesa teknike ka pas ankesë për UPS GR i OE-ve te rekomanduar për kontrate i plotëson te gjitha specifikimet teknike sipas kërkesave te vendosura nga ne si AK, përfshira edhe dokumentacionin përcjellës te kërkuar nga Autoriteti Kontraktues siç janë flet garancioni 2 vjeçar nga prodhuesi, deklarata se UPS i plotëson spec.teknike te detyrueshme, deklaratën për pjese rezerve për vitet ne vijim si dhe katalogun te vendosur dhe nënshkruar, prandaj produkti i ofrua.

Është kërkuar kamerë BULLET 2MP kurse nga OE te përzgjedhur është prezantuar DOME kamerë e cila është ne harmoni te plote me spec.teknike te FDT-së sepse siç kemi potencuar ne paramas dhe specifikim citon” ne rast se spec.teknik te cekur me lart i jemi referuar ndonjë artikulli Brendi marka tregtare apo shenja dalluese për ta qartësuar me saktë spec.teknik ne te gjitha këto raste vlen APO EKUIVALENT’, andaj edhe AK konsideron se kjo pajisje është ne harmoni te plote.

Monitori lidhur ne pretendimin e palës ankimore sa i përket Monitori industrial ne kemi verifikuar pret, e palës ankimore dhe i njëjti është lehtë te verifikohet ne linkun DAHMAS e qe është verifikuar dhe për ne edhe ky pretendim është i pa bazuar.

Tek çmimi kriteri i vendosur nga AK është oferta e përgjegjshme me çmim me te ulet dhe pala ankimore ne këtë rast pala ankimore ka ofruar çmimin me te ulet mirëpo duhet te jete i përgjegjshëm edhe nga ana administrative dhe teknike.

Pala e rekomanduar për kontrate ka ofruar çmim brena buxhetit për këtë kontrate po ashtu është i përgjegjshëm edhe nga ana teknike dhe ajo administrative.

Pala ankimore sipas neve ehte e pa përgjegjshme ne pikat qe do ti citojmë me poshtë: Specifikimi i teknik i prezantuar nga OE ankues nuk i plotëson as përafërsisht as spec.teknike te kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe atë si ne artikujt ne vijim: Artikujt ne pozicionin 2,3,4, 6, 9, 25,2,21,25, 26,dhe 27, mangësitë ne spec, e ofruara i kemi bashkangjitur ne formë shtojcë me mangësitë e potencuar gjatë vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit te ofertave.



Katalogët e prezantuar nuk i plotësojnë specifikat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues nuk janë te vulosura dhe te nënshkruar nga OE dhe për një pjesë të katalogut nuk kanë qenë prezent fare. Në pikën 4 të nenit 7.1 dhe 7.2 të kërkesat e përshtatshmërisë profesionale OE nuk ka prezantuar nga prodhuesit siç janë kërkuar për artikuj 1-21 siç janë: UPS, Kabllo Fiber, HDU inteligjent Suic e tej .

Tek dokumenti që u çek nga OE ankues dokumenti MAF në kemi bërë verifikimin tek prodhuesi ku rezultojë se i njëjti dokument i prezantuar nga pala ankimore nuk është konfirmuar si valid nga ana e prodhuesit dhe si të tillë nuk kemi mundur ta marrim fare për bazë. Ndonëse për Gr e OE-ve fitues për këtë AP nga po i njëjti prodhues ju ethe konfirmuar dokumenti dhe origjinaliteti i tij dhe përkrahja nga prodhuesi për këtë AP. Këtu u çek nga pala ankimore se me vone pas konsultave kanë marrë një dokument tjetër por prapë se prapë OE ankues nuk i plotëson kërkesat e lartcekura të shpallët fitues. Po ashtu u çek se OE ankues me një staf prej 175 punëtor, prej krejt kontratave i ka vetëm një në renovimin e stadiumit të Prishtinës.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Teknik z. Jaha deklaroj: Të gjitha këto i kame verifikuar, vetëm një pikë e çeku këtu vetëm pjesë e zërimit dhe nuk është pjesë e ankese edhe pse zerimi është pika 27 e paramasës për të cilën nuk është kërkuar katalog për të gjitha të tjerat qëndrojnë prapa raportit të dhënës në ekspertizë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së ankues Nishevcu deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Obertinca deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të hedhë poshtë ankesën e OE-se si të pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se lideri i grupit të operatorëve ekonomik të propozuar për nënshkrimin e kontratës “ENTERI” SH.P.K. ka ofruar pasqyrën tabelave të stafit prej 11 personave teknik, përfshirë këtu edhe vendimin për menaxherin e projektit, ndërsa kërkesa në DT është për minimum 8 punëtorëve teknik. Prej të cilëve dy Inxhinjera të Elektroteknikës dhe dy Inxhinjera të Informatikës, që të gjithë me më shumë përvojë pune se sa që është kërkesa nga AK.

Paneli shqyrtues, poashtu konstaton se lideri i grupit të operatorëve ekonomik, ka përfshirë edhe: diplomat, CV-të, rekomandimet dhe kontratat e punës në kohë të caktuar për të gjithë të punësuarit të paraqitur në listën e projektit, në përputhje gjithashtu me kërkesat në DT. Ndërsa për punëtorin z. Bujar



Zabeli, inxhinier i informatikës, i cili është pjesë e listës prej 12 personave të paraqitur nga lideri i grupit të operatorëve ekonomik, përpos diplomës dhe certifikatave të ndryshme të CCNA e ka të prezantuar edhe certifikatën e kërkuar të CCNA për rrjetat e telekomunikimit.

Paneli shqyrtues sqaron se lideri i grupit të operatorëve ekonomik të shpërblyer me kontratë, gjithashtu posedon dhe i ka të bashkangjitura në DT edhe 10 certifikata të lëshuara nga prodhuesi i kamerave Dahua për certifikim të 10 nga 12 personave të paraqitur në listën e punëtorëve të udhëheqësit të grupit të OE, për punë me mjete për video vëzhgime, certifikata të lëshuara para hapjes së këtyre ofertave, në përputhje me kërkesat në DT.

Paneli shqyrtues konstaton se lista e punëtorëve, diplomat, referencat, CV-të dhe dokumentet tjera relevante, të cekura në ankesën e OE ankues, janë në përputhje me kërkesat në DT .

Pretendimi i OE ankues se kontratat e punëtorëve dhe certifikatat nga prodhuesi i pajisjeve video vëzhguese duket se janë në fazë të re dhe se kuptohet qartë që provoja dhe eksperiencat e punës në këtë lami është e pakët tek stafi teknik ku konkretisht me brendinë e paraqitur, paneli shqyrtues konsideron se është i pabazuar, pasi që nuk është me rëndësi kur janë lëshuar certifikatat, ato janë në përputhje me kërkesën në DT dhe i përmbajnë të gjitha specifikat e kërkuara. Përvoja e OE dëshmohet me kontratat dhe referencat e bollshme të cilat i ka të prezantuara në DT.

Pretendimi i OE ankues se kontratat për të gjithë janë të nënshkruara në të njëjtën ditë me dorëzimin e tenderit në fjalë, paneli shqyrtues vlerëson se është i pabazuar pasi që kontratat janë me afat të caktuar dhe të dedikuara për këtë projekt, në përputhje me kërkesat dhe specifikat e DT.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se tek inxhinieri i prezantuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik i përzgjedhur për nënshkrimin e kontratës në dokumentin identifikues është me mbijetës tjetër nuk e kemi të qartë se për cilin person bëhet fjalë këtu apo nuk ekziston fare, paneli shqyrtues konstaton se në dokumentacionin e ofertës së OE të rekomanduar Inxhinieri i Diplomuar i Elektroteknikës, i drejtimit Automatika dhe Elektronika, është z. Zymer Veliu, në diplomën e kryerjes së studimeve Universitare të lëshuar me datë 30.09.1999 me nr. rendor 1271, në CV, Referenca dhe kontratë të punës me liderin e grupit të Operatorëve Ekonomik të shpërblyer me kontratë, është i identifikuar me emrin Zymer Veliqu, me ditëlindje të njëjtë, kurse në dokumentin identifikues, në certifikatën e diplomës Master nga një Universitet në Zhenevë të Zvicrës dhe në dy certifikata të trajnimeve është i identifikuar me emrin Zymer Veliu. Paneli shqyrtues konstaton se AK me rastin e rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit konform nenit 72 duhet të kërkojë sqarime nga vet personi i apostrofuar z. Zymer Veliu për të sqaruar këtë çështje.



Pretendimi ankimor se specifikat teknike te dorëzuara nga Grupi i Operatoreve ekonomik i përzgjedhur për nënshkrimin e kontratës ku sipas nesh janë specifika te cilat nuk janë ashtu si janë kërkuar, UPS e ofruar nuk është sipas kërkesës se AK se, janë paraqitur ata te cilët nuk i plotësojnë kriteret e dosjes se tenderit, paneli shqyrtues konstaton se te dokumenti “Paramasat për Kamera” nën numrin rendor 21 është artikulli “UPS 20 kVA BRAND NAME”, me sasi një (1) copë. OE, pjesë e grupit te OE te shpallur fitues ka ofruar katalog te detajuar te produktit “PHOENIX 3SU ONLINE UPS” me përshkrim te specifikave teknike. Deklarate për plotësim te standardit ISO 9001-2015, deklaratë te konformitetit dhe garancion për furnizim me pjesë rezervë për 10 vite pas instalimit, si dhe deklaratë për Garancion prej 24 muajve, të nënshkruar dhe të vulosur nga ana e liderit të Grupit. Karakteristikat dhe kërkesat teknike te paraqitura në Paramasë të DT, janë të paraqitura edhe në katalogun e bashkangjitur nga ana e OE fitues, kurse për disa pozicione paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues përkatësisht teknik konstaton se eksperti teknik kontaktuar me anë të e-mailit prodhuesin e produktit i cili i ka konfirmuar specifikimet teknike për të cilat pretendon OE ankues dhe konform mendimit të ekspertit teknik paneli shqyrtues konstaton se produkti i ofertuar nga grupi i OE, është në përputhje të plotë me kërkesat dhe karakteristikat e kërkuara në Paramasën e DT nga ana e AK-së.

Pretendimi ankimor i OE ankues se tek sistemi i kamerave nga AK ja është kërkuar kamere Bullet 2MP, kurse nga operatori i përzgjedhur është prezantuar DOME kamere, qe nuk përputhet me kërkesën, paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues përkatësisht teknik konstaton se kamerat e ofruara nga Grupi i OE të përzgjedhur për kontratë, karakteristikat funksionale dhe teknike të cilave janë të përshkruara në pozicionet 1, 2 dhe 3 të Paramasës në DT, i plotësojnë të gjitha kërkesat e paraqitura në DT. Kamera e ofruar nga Grupi i OE të përzgjedhur për kontratë, e cila është e përshkruar në pozicionin 4 të paramasës, i plotëson të gjitha kërkesat e paraqitura nga ana e AK në DT.

Sa i përket emërimit DOME te kjo kamerë dhe/apo BULLET si emërtim mund të kompensohet me kushtin/kriterin e përcaktuar si ekuivalent sepse kamera e ofruar nga grupi i OE të shpallur fitues i plotëson të gjitha kërkesat dhe specifikat e kërkuara nga ana e AK-së dhe të paraqitura ne Paramasë, si e tillë nuk mund të refuzohet bazuar në emërtimin DOME apo BULLET pasi që e njëjta i përmbush specifikimet teknike sipas FDT-së.

Pretendimi ankimor se tek monitori i kërkuar nga AK ja është industrial 24/7, kurse Grupi i Operatoreve ekonomik i përzgjedhur, ka ofruar monitor Jo industrial 24/7, qe nuk është ne përputhje me kërkesat e FTD-se, sipas specifikave teknike, paneli shqyrtues konstaton se grupi i operatorëve ekonomik të shpërblyer me kontratë, për pozicionin 6 te paramasës ka ofertuar me produktin LM49-S400, 49’’ UHD LED monitor (gjithsejtë 4 copë), që është i brendit të njëjtë me kamerat, pra Dahua. Monitori i ofruar i



plotëson të gjitha kërkesat teknike të paraqitura në paramasë, të cilat i kam verifikuar në katalogun e dorëzuar nga OE fitues dhe në atë të shkarkuar nga ueb faqja e prodhuesit, në të cilin, ndër karakteristika të tjera, shkruan edhe: “Industrial level LCD panel, suitable for continuous 24/7 operation”, andaj duke u bazuar në sqarimet e ekspertit shqyrtues teknik paneli shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor se OE ankues ka ofertuar me çmim me te lire diku 8,000.00 euro, gjë që kemi çmim me te lire dhe ekonomikisht me te favorshëm, ku AK-ja duhet ta marre parasysh këtë faktë ku si kriter bazik çdo here është Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin me te ulet, paneli shqyrtues konstaton se oferta e OE ankues është më e ulët dhe se AK me rastin e vlerësimit të ofertave nuk ka vepruar në harmoni me nenin 60 paragrafi 1 pika 1 e LPP-së.

Paneli shqyrtues pas analizimit të deklaratës së përfaqësuesit të OE ankues në seancën dëgjimore konstaton se AK nuk ka bërë analizimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së pasi që me rastin e shpalljes së OE ankues të përgjegjshëm për shkak të autorizimit MAAF- dokumenti nga ana e prodhuesit nuk është i prodhuesit dhe nuk është i autorizuar nga prodhuesi andaj në këtë rast paneli shqyrtues konstaton se AK me rastin e rivlerësimit konform nenit 72 të LPP-së duhet të verifikojë pretendimet e OE ankues se stafi i ri nga Shqipëria ka deklaruar se nuk ka dhënë autorizimin për faktin se kemi të bëjmë me po të njëjtin prodhues dhe të dy kanë të bëjnë me produkte të njëjta, andaj duke pasur parasysh këtë, dhe çmimin më të ulët të OE ankues paneli shqyrtues obligon AK-në që konform nenit 72 të kërkojë sqarime shtesë lidhur me autorizimin në fjalë dhe pretendimet ankimore të OE ankues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK - “KK Fushë Kosovë”
- 1x1 OE - “BM GROUP”SH.p.k-Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran MILENKOVIC